



Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.02.2023

UDHËRRËFYES MBI SHËRBIMET QË OFROHEN NGA ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Rreth këtij udhërrëfyesi

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një ent publik që trajton çështjet që lidhen me licencimin e subjekteve të cilat operojnë në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror, përcaktimin e tarifave të operatorëve të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror si dhe çmimet për klientët e shërbimit universal, çertifikimin e operatorit të rrjetit të transmetimit, monitorimin e tregut të energjisë, miratimin e planeve të operatorëve të rrjetit, trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve. ERE në ushtrimin e detyrave ekuilibron interesat e investitorëve, konsumatorëve dhe shtetit për të siguruar nga të licencuarit shërbim të sigurt dhe të bazuar në kosto të arsyeshme. ERE gjithashtu shërben si burim informacioni në lidhje me shërbimet e ofruara nga të licencuarit dhe në tërësi për kuadrin rregullator. Përveç kësaj ERE është e përfshirë aktivisht në organizatat rajonale, apo dhe në marrëveshje bashkëpunimi në lidhje me çështjet e shërbimeve që ndikojnë në tregun e energjisë. Si pjesë e rolit të saj, ERE përpiqet të jetë e hapur dhe transparente në ofrimin e shërbimeve ndaj të gjitha palëve të interesuara. Udhërrëfyesi i Shërbimeve do të shërbejë si një burim që përmban informacione apo shpjegime për proceset dhe procedurat rregullatore në sektorin e energjisë. ERE synon që ky Udhërrëfyesi të përditësohet në kuadër të ndryshimeve në aktet rregullatore. Është e rëndësishme të theksohet se Udhërrëfyesi i Shërbimeve është konceptuar si një pikënisje në të kuptuarit e shërbimeve rregullatore por në çdo rast ERE do të sigurojë informacione të tjera brenda fushës së përgjegjesisë për çdo palë të interesuar që mund të kërkojë më shumë informacion.

Udhërrëfyesi i Shërbimeve synon të ofrojë për lexuesin një kuptim gjithëpërfshirës të sektorit të energjisë, shërbimeve të ERE dhe rolin e saj.

Informacioni në këtë udhëzues është i organizuar në seksionet si vijon:

1. Koncepte të përgjithshme mbi Entin Rregullator të Energjisë
2. Rregullat dhe procedurat që ndjek ERE
3. Përcaktimi i tarifave

4. Monitorimi i tregut të energjisë
5. Hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore
6. Mbrojtja e konsumatorit
7. Angazhimi me palet e treta dhe institucionet ndërkombëtare

1. KONCPETE TË PËRGJITHSHME MBI ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISE

1.1 Krijimi i ERE

Në vitin 1995 vendoset me ligji ngritja e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike si autoritet përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike.

ERE është krijuar në vitin 1995, me miratimin nga Kuvendi të ligjit Nr. 7962, datë 13.07.1995 “Për Energjinë Elektrike“ dhe ligjit Nr. 7970, datë 20.07.1995 “Për Rregullimin e Sektorit të Energjisë Elektrike”

Në vitin 2003 miratohet ligji Nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i cili shfuqizoi ligjet e mëparshme.

Në vitin 2006 ky ligj pëson shtesa dhe ndryshime në nene të veçanta të tij. Në vitin 2008 në fushën e përgjegjësisë së ERE përfshihet edhe rregullimi i sektorit të gazit natyror.

Aktualisht, veprimtaria e ERE, rregullohet në bazë të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike“ dhe ligjin Nr. 105/2015 “Për sektorin e gazit natyror“.

Në bazë të ligjeve të sipercituara, ERE funksionon si Ent publik jobuxhetor i pavarur nga pikpamja e financimit dhe vendimmarrjes.

ERE miraton vendimet e saj në bazë të ligjit dhe përcakton procedurat dhe rregulloret për organizimin, operimet për çështjet në fushën e përgjegjësisë së saj. Vendimet e ERE janë të apelueshme vetëm në gjykatë.

Burimet për funksionimin e ERE nuk vijnë nga buxheti i shtetit, por vijnë nga

- pagesat e licencimit
- pagesat e rregullimit

Përcaktimi i buxhetit të ERE-s:

Bordi i Komisionerëve ka kompetencë për të miratuar projekt – buxhetin e ERE-s.

Kontrolli i buxhetit përfshin:

Auditim nga ekspert të miratuar kontabël

Raportim i buxhetit në Kuvendi

APP – për prokurimet publike të kryera nga ERE.

Shpërndarja e të ardhurave në buxhet konsiston në:

- shpenzime për paga dhe shpërblime
- shpenzime për investime
- shpenzime për trajnime dhe aktivitete ndërkombëtare
- shpenzime për botime

ERE nga pikpamja buxhetore është një institucion i pavarur. Buxheti vjetor i ERE-s krijohet nga pagesat e aplikimit për licencim si dhe nga pagesat e rregullimit që bëjnë të licencuarit bazuar në një metodologji dhe në një proces transparent e jo diskriminues. Referuar nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe nga pagesat e licencave. ERE mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin. ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj. Pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52 të nenit 3 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe pikës 69 të nenit 4 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, llogaritet dhe mbledhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licencuar, në përputhje të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar.

1.2 Kompetencat

ERE është një organ i administratës publike i organizuar si ent publik, fusha e përgjegjësisë së të cilit përfshin kompetenca në drejtim të:

➤ Hartimi i akteve rregullatore

ERE miraton aktet rregullatore në tregun e energjisë lidhur me ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë, përfshirë kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara.

➤ Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Trajton mosmarrëveshjet në lidhje me ankesat e klientëve ndaj të licencuarve dhe ndërmjet të licencuarve.

➤ Shqyrtimi i planeve të investimeve

Shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të rregulluar.

➤ **Licencimi i subjekteve në tregun e energjisë**

Trajton kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave për ushtrimin e aktiviteteve në veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike. Në sektorin e gazit natyror, ERE shqyrton aplikimet për licencim për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë.

➤ **Përcaktimi i Tarifave**

Aktivitetet që lidhen me detyrimet e shërbimit publik nga të licencuarit realizohen me tarifa dhe çmime të përcaktuara nga ERE. Rritja e kërkesës për energji, nevoja për zgjerimin e rrjetit apo mirëmbajtje, zhvillimi teknologjik ndikon në kostot e shërbimit, dhe si të tillë në çmimin e shitjes së energjisë elektrike.

➤ **Axhustimi i tarifave**

ERE rishikon investimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara/miratuara çdo fundviti dhe korrigjon tarifat në rast se operatori nuk realizon planin e investimeve.

➤ **Kostot që përbëjnë çmimin në faturën e energjisë elektrike**

Për të kuptuar se çfarë kostosh përmban çmimi i energjisë elektrike, është e rëndësishme të identifikohen zërat për secilin element. Kur ju merrni faturën e energjisë elektrike, shumat e treguar në të nuk përfaqëson vetëm konsumin e lëndës së parë (energjisë elektrike), por shumën e një sërë elementësh fiks dhe të ndryshueshëm të cilët të gjithë bashkë përbëjnë çmimin final të energjisë elektrike.

Zërat kryesorë të çmimit të energjisë elektrike:

- Kosto e blerjes së energjisë elektrike
- Kosto për Transmetimin e energjisë elektrike
- Kosto për Shpërndarjen e energjisë elektrike
- TVSH dhe taksa.

Kostot për blerjen e energjisë elektrike ndahen sipas tipit të furnizimit:

- për klientët të cilët furnizohen në kushtet e shërbimit universal ose thënë ndryshe në tregun e rregulluar (0.4 kV)
- për klientët në treg të liberalizuar,

- për klientët të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit të ndarë sipas niveleve të tensionit (35 kV dhe 20-6 kV),

Kostove të mësipërme u duhen shtuar tarifat e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, të cilat korrespondojnë me kostot për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kombëtar të energjisë elektrike. Këto tarifa përfaqësojnë kosto fikse të faturës së energjisë elektrike, të vendosura nga ERE dhe janë të aplikueshme ndaj të gjithë klientëve fundorë në treg të lire ose jo. Taksat janë gjithashtu element i faturës së energjisë elektrike dhe përbëhen nga TVSH-ja e llogaritur mbi shumën totale të elementëve përbërës të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për energjinë e konsumuar, si dhe nga taksa që vendosen sipas rastit të tilla si taksa e televizionit, e të tjerë, element të cilët gjenden të renditur në faturën e energjisë elektrike.

TVSH përfaqëson 20 %, të vlerës totale të faturës ndërsa taksa e televizionit përfshin vlerën prej 100 lekë dhe është një taksë e cila nuk lidhet me konsumin e energjisë elektrike.

➤ **Monitorimi**

Ligji përcakton të drejtën e ERE për të monitoruar dhe kontrolluar funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe për të detyruar të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut. Po ashtu ERE monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licencuarve duke ushtruar të drejtën e aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë si dhe kontrollon nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE. Në çdo rast monitoron kryerjen e veprimtarisë nga operatorët e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik. Monitorimi nga ERE realizohet përmes mbledhjes së informacionit, analizimit dhe marrjes së vendimeve në bazë të informacionit në dispozicion. Sa më sipër është komplekse dhe mund të kërkojë ekspertizë nga disa fusha në varësi të natyrës së informacionit të përpunuar. Në një proces moniotrimi gjithmonë janë dy aktorë të rëndësishëm të përfshirë në veprimtarinë e monitorimit dhe këto janë nga një anë:

Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike: - janë kryesisht përgjegjës për dërgimin e informacionit dhe zbatimin e udhëzimeve dhe urdhrave të rregullatorit.

Personeli i ERE: - përdor informacionin, raportet, informacionin e përftuar nga jashtë dhe analizat e veta për të mbështetur proceset e saj vendimmarrëse.

➤ **Mekanizma për zbatimin e vendimeve:**

Legjislacioni i sipërcituar përcakton gjithashtu ERE në cilësinë e organit që ka të drejtë të vendos gjoba për të licencuarit që nuk përmbushin detyrimet që burojnë nga ligji për sektorin e energjisë si dhe të procedojë me heqje të licencës për shkelje të përsëritura nga i licencuari.

Gjithashtu, ERE mund të nis një procedurë kontrolli mbi aktivitetin e të licencuarit që mund të çojë në një rishikim të tarifave të përcaktuara, i tillë është rasti kur treguesit që kanë shërbyer për përcaktimin e një tarifë kanë rezultuar në kohë të porealizuara.

1.3 Organizimi i ERE

ERE është një person juridik publik, me seli në Tiranë dhe përbëhet nga Bordi i Komisionerëve me një Kryetar dhe 4 anëtarë, të cilët kanë funksion vendimmarrës dhe emerohën nga Kuvendi i Shqipërisë. Përveç Bordit, është dhe personeli teknik i organizuar në Drejtori dhe Sektore. Pjesë integrale e Strukturës aktuale të ERE janë dhe Këshilltari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Bordi i Komisionerëve

Bordi i Komisionerëve emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë dhe është organi vendimmarrës i institucionit. Ai përbëhet nga:

- 5 anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti me propozim të ekipit përzgjedhës
- mandat të përcaktuar dhe me të drejtë rizgjedhje një herë.

Zgjedhja e organit drejtues

Ekipi përzgjedhës i Bordit përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht, kryetari i komisionit përgjegjës për energjinë dhe kryetari i komisionit përgjegjës për ekonominë dhe nga ministri përgjegjës për energjinë. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit apo njërit prej anëtarëve të bordit, Kuvendi publikon njoftimin për vendin vakant. Ekipi Përzgjedhës përzgjedh paraprakisht dy kandidatë që plotësojnë kërkesat e pikës 5 të këtij neni dhe ia propozon Kuvendit të Shqipërisë. Kryetari dhe anëtarët e Bordit janë persona që duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Kryetari është një person i shquar në fushën e energjisë. Ai/ajo duhet të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë;
- b) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë elektrike dhe të jetë me profesion inxhinier elektrik;
- c) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e hidrokarbureve dhe të jetë me profesion inxhinier në sektorin e naftës dhe/ose gazit;

ç) dy anëtarët e tjerë, respektivisht njëri me profesion jurist dhe tjetri ekonomist, duhet të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune, prej të cilave të paktën 5 vjet duhet të jetë eksperiencë në sektorin energjetik.

Kur vendi i kryetarit të Bordit mbetet vakant, anëtari i Bordit me kohën më të gjatë në detyrë kryen funksionet e kryetarit deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është emëruar si anëtar bordi.

Përfundimi i mandatit

Kryetari dhe anëtarët e Bordit shkarkohen nga detyra nga Kuvendi vetëm në rast se:

- a) veprojnë në kundërshtim me parimin e pavarësisë apo janë në konflikt interesi;
- b) dënohen për kryerjen e një vepre penale me një vendim gjykate të formës së prerë.

Kryetari dhe anëtarët e bordit lirohen nga detyra nga Kuvendi kur:

- a) japin dorëheqjen;
- b) kandidojnë për t'u zgjedhur deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- c) kandidojnë për t'u zgjedhur në organet e një njësie vendore;
- ç) bëhen të paafte për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-s për një periudhë mbi 6 muaj;
- d) mungojnë në detyrë, pa shkak, për një periudhë mbi një muaj.

Para se të shkarkohen, kryetarit dhe anëtarit të bordit të ERE-s u jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tyre para komisioneve të Kuvendit. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar kryetarin apo anëtarët duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë shkarkimin e tyre. Kryetari dhe anëtarët e Bordit, të shkarkuar nga detyra, nuk kanë të drejtë të rizgjidhen më në Bordin e ERE-s. Shkarkimi ose lirimi i kryetarit dhe anëtarëve të bordit, sipas pikave 1 dhe 2, bëhet me miratim të Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të Ekipit Përzgjedhës.

Vendimmarrja e ERE-s

Vendimet e Bordit merren me shumicë votash. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote. Kur numri i votave është i barabartë, decisizive është vota e kryetarit. Votimi është i hapur, mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të bordit janë të hapura. Në raste të veçanta, që kanë të bëjnë me trajtimin e çështjeve me karakter të brendshëm, bordi mund të zhvillojë mbledhje me dyer të mbyllura, në përputhje me përcaktimet e rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s. Mbledhjet e bordit zhvillohen me pjesëmarrjen e jo më pak se tre anëtarëve dhe vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të bordit. Të gjitha vendimet e bordit shoqërohen me një relacion argumentues.

Të gjitha vendimet e bordit, përveç atyre me karakter të brendshëm organizativ të ERE-s, botohen në Fletoren Zyrtare. ERE publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e marra dhe njoftimin për shtyp për çdo vendim.

Rishikimi dhe apelimi

Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara. Vendimet e bordit të ERE-s ankimohen në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

Në çdo rast organi vendimmarrës merr vendime bazuar në dokumentat dhe provat e administruara gjatë procedurave të ndjekura në ERE.

Vendimarrjet dhe në tëresi veprimtaria e ERE synon të ekuilibrojë interesat e shtetit, konsumatorëve dhe të licencuarve për të marrë vendime në interes të publikut duke siguruar që të licencuarit të ofrojnë shërbim të sigurt dhe të besueshëm bazuar në norma të drejta dhe të arsyeshme. ERE gjithashtu shërben si burim i të drejtës në sektorët e rregulluar prej saj duke krijuar akte rregullatore dhe po ashtu siguron informacion në lidhje me shërbimet dhe procesin rregullator. ERE është anëtare e disa organizatave rajonale në lidhje me çështjet e shërbimeve që ajo rregullon.

Personeli teknik dhe mbështetës

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ndër të tjera ka përcaktuar mënyrën e funksionimit dhe organizimit të ERE-s, duke vendosur në nenin 11, pika 7, të drejtën e Bordit në cilësinë e organit vendimmarrës për të përcaktuar strukturën organizative të ERE-s, numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të Kryetarit, anëtareve të Bordit si dhe të punonjësve të ERE-s.

Sipas ligjit bazë të funksionimit të ERE-s, ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike, neni 10 pika 1, dhe neni 14, ERE në kryerjen e funksioneve të saj ndihmohet nga një personel teknik. Në nenin vijues 11 pika 7, thuhet se: *Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik.*

PËRZGJEDHJA E STAFIT

A - Kriteret

Kritere të përgjithshme të përcaktuara në Ligjin “Për nëpunësin civil”.

Kritere të veçanta sipas pozicionit të punës që përcaktohen nga Bordi i Komisionerëve.

B - Konkurimi

-Konkursi zhvillohet nga një Komision i posatshtëm.

-Komisioni i propozon kryetarit kandidatin me rezultatet më të mira

-Kryetari përzgjedh kandidatin e propozuar.

C- Emerimi në detyrë konsiston në:

Periudha e provës

Konfirmimi në detyrë

Struktura organizative e ERE reflekton nevojën për personel për përmbushjen e përgjegjësisë të përcaktuara ndaj kësaj të fundit sipas ligjeve të sipërcituara apo dhe detyrave që dalin në zbatim në përpilimin e kuadrit rregullator në zbatim të këtyre detyrimeve si në fushën kombëtare ashtu dhe në atë ndërkombëtare. Aktualisht struktura organizative e ERE konsiston në:

Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes

Bazuar në standardet, kushtet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, në zbatim të legjislacionit në fuqi, DLAM, propozon dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave për të gjithë të licencuarit që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë sipas aktiviteteve të përcaktuara në ligj. Përgatit propozimet përkatëse në lidhje me kërkesat për çdo autorizim që lidhet me kalimin/transferimin e kuotave, aseteve, etj. Ndjek procedurat e çertifikimit dhe kontrollit të zbatimit të kushteve të vendimeve të çertifikimit, raportimet e zyrtarit të pajtueshmërisë/përputhshmërisë, praktikat në lidhje me kualifikimet e burimeve të rinovueshme. Ndjek procedurat e dhënies së çertifikatave të garancive të origjinës dhe mban në bashkëpunim me Specialistin e IT rregjistrin dhe platformën e Garancive të Origjinës. Përdor procedurat e miratuara nga ERE për të nxitur konkurrencën e drejtë; monitoron/mbikëqyr dhe inspekton veprimtarinë e të licencuarve, zbatimin e kushteve të licencave dhe vlerëson raportet e tyre; përgatit programe inspektimi dhe monitorime kur e sheh të arsyeshme, apo me urdhër të Kryetarit apo anëtarëve të Bordit, si dhe propozon masat përkatëse kur konstatohen mosrespektime të kushteve të licencave nga të licencuarit.

Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarreveshjeve

DJZM, vepron si përfaqësues ligjor i ERE- s; përgatit vendimet dhe urdhërat e ERE-s në konformitet me legjislacionin në fuqi. Bazuar në informacionin e siguruar nga drejtoritë e

tjera dhe në bashkëpunim me ta, Këshilltarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm, merr pjesë në përgatitjen e raportit vjetor dhe raporteve periodike sipas manualit të raportimit të Kuvendit, për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarive të ERE- s, përfshirë dhe veprimtaritë financiare. Ai kujdeset që ky raport, pasi të shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi, të paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë në afatin e caktuar me ligj dhe botimin e tij në Fletoren Zyrtare. Në çdo rast të paraqitjes së praktikave për shqyrtim në Bord nga Drejtoritë teknike, DJZM përgatit kur i kërkohet opinion mbi sa propozuar Bordit nga drejtoritë respektive, apo me iniciativën e saj nëse ka qëndrim të ndryshëm nga sa propozuar në aktet për të cilat është vënë në dijeni.

Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve

DTÇ, bazuar në metodologjitë dhe legjislacionin në fuqi, për vlerësimin e kostos dhe miratimin e tarifave dhe çmimeve, si dhe në aktet e tjera të aprovuara nga ERE, vlerëson tarifat dhe çmimet në përputhje me afatet e aprovuara për të siguruar që janë të mjaftueshme për sigurimin e shërbimit të aktiviteteve të rregulluara në sektorin e energjise në përputhje me standartet në fuqi.

1. Zbaton parimet e metodologjive respektive, vlerëson dhe kontrollon shpërndarjen e drejtë të kostove për aktivitetet e rregulluara të sektorit të energjise elektrike, bazuar në specifikat e sistemit, duke i mbajtur vlerat e tarifave dhe çmimeve të rregulluara të klienteve në nivele të arsyeshme dhe të drejta, në mënyrë që i licencuari të opërojë me efektivitet, të mbulojë koston aktuale dhe të sigurojë vazhdimin normal të veprimtarisë në të ardhmen.

2. DTÇ është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjive të tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në analizat e saj propozon përmirësime të metodologjive ekzistuese.

3. DTÇ është përgjegjëse për mbledhjen dhe e analizën e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për propozime të arsyeshme në lidhje me dhe strukturën e nivelin e tarifave dhe çmimeve.

4. Në bashkëpunim me SMT, merr pjesë në shqyrtimin e programit të investimeve të të licencuarve, për të vlerësuar. Nëse janë hartuar në përputhje me rregulloren përkatëse dhe në zbatim të parimeve të planifikimit me kosto efektive dhe kritere të tjera të rëndësishme.

Drejtoria e Monitorimit të tregut

DMT, bazuar në legjislacionin në fuqi, monitoron, kontrollon dhe inspekton funksionimin e tregut të energjisë elektrike në mënyrë që të sigurohet nxitja e konkurrencës efektive, transparenca dhe siguria e funksionimit të tregut të energjisë elektrike, përfshirë dhe

shërbimet e balancimit si dhe monitoron zbatimin e rregullave të blerjes së energjisë elektrike; zbatimit të planit të investimeve; zbatimin e Kodeve të rrjetit dhe matjes së energjisë elektrike si dhe sigurinë kibernetike “cyber security” për operatorët. Përgatit praktika për marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme nga pjesëmarrësit e tregut dhe të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për përpilimin e raporteve përkatëse.

Drejtoria e Gazit Natyror

Zbaton të gjithë legjislacionin në fuqi për sektorin gazit natyror në kryerjen e detyrave që kanë lidhje me licencat dhe të licencuarit si dhe bashkëpunon me Drejtorinë e licencimit në ERE. Bashkëpunon me Drejtorinë e Monitorimit të Tregut për monitorimin e aktivitetit të licencuarve lidhur me zbatimin e kushteve të licencave përkatëse, vendimeve të EREs, rregullave si dhe për çështje të tjera. Në bashkëpunim me Sektorin e Monitorimit të Tregut shqyrton dhe vlerëson programet e investimeve të të licencuarve (aspektet inxhinierike). Në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të DTÇ harton Metodologjitë e llogaritjes së tarifave në sektorin e gazit natyror. Ndjek dhe kontrollon strukturën e tarifave sipas aktiviteteve të licencuara. Formulon udhëzime në lidhje me të dhënat kontabile, financiare apo të dhëna shtesë që lidhen me procesin e rishikimit të çmimit, strukturës së tarifave, sipas metodologjive të aprovuara. Vlerëson drejt dhe me kujdes saktësinë e llogaritjes së kostove dhe kërkesat për të ardhura të paraqitura nga ana e të licencuarve. Ndjek dhe kontrollon uniformitetin e mbajtjes së llogarive për të gjithë të licencuarit, si kriter për hartimin e strukturës së tarifave. Kijon dhe mban lidhje me njësi të rregullatorëve të vendeve të tjera.

Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit Performances dhe Standardeve

Trajton dhe zgjidh të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klienteve, si dhe midis të Licencuarve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera, ushtron kontrole në Operatorin e Transmetimit, Operatorin e Shpërndarjes, Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Furnizues të tjerë për zbatimin e kushteve të Kontratës së Furnizimit me energji elektrike dhe Rregullores së Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Rregullave të cilësisë së shërbimit në aktivitetin e transmetimit. Përgatit rekomandime dhe asiston në hartimin e akteve ligjore dhe legjislacionin sekondar të ERE-s lidhur me çështjet e mbrojtjes së klienteve. Kryen sondazhe për të ekzaminuar dobishmërinë e

shërbimeve të kompanisë kundrejt furnizuesit dhe kryesisht lidhur me vazhdimësinë e furnizimit, treguesit të standardeve të garantuara dhe cilësisë së furnizimit, aktivitetit të furnizuesit për transparencën ndaj klientëve. Informon klientet për të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe për mundësinë që ata kanë për të kërkuar informacionin e nevojshëm dhe rrugën e zgjidhjes së problemeve. Përgatit dhe organizon seancat dëgjimore si dhe siguron transparencën dhe kujdeset për pjesëmarrjen e publikut dhe të grupeve të interesit në këtë proces. Kujdeset dhe bashkëpunon me Shoqatat e Konsumatorëve dhe të përfaqësuesve kryesorë të përdoruesve dhe mban kontaktë të vazhdueshme me ta.

Drejtoria e Financës dhe IT

Përgatit buxhetin vjetor të ERE-s me të ardhurat dhe shpenzimet të detajuara. Për këtë bashkëpunon paraprakisht me sektorin e burimeve njerezore, strukturat e tjera dhe brenda muajit mars të çdo viti e paraqet për miratim në Bord projektin e përgatitur. Ndjek periodikisht realizimin e planit të ardhurave dhe shpenzimeve të ERE-s, sipas Buxhetit të miratuar. Bashkëpunon me Grupin e Punës që ngrihet me urdhër të Kryetarit për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin respektiv. Kontrollon në mënyrë rigoroze shpenzimin e fondeve të ERE-s, duke u kujdesur që çdo shpenzim të jetë i justifikuar nga pikëpamja ligjore dhe i domosdoshëm. Kryen të gjitha veprimet që duhen për pagesën e punonjësve si dhe kryen të gjitha likuidimin për shërbimet të kryera jashtë dhe brenda vendit.

Sektori i Burime Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Koordinon procesin e rekrutimit të stafit nëpërmjet evidentimit të nevojave të institucionit për burimet njerezore dhe merr masat për rekrutimin e stafit nëpërmjet nevojave të institucionit sipas legjislacionit në fuqi. Për emërimet e reja të personelit, ndjek zbatimin e kriterëve të përcaktuara në ligj. Bashkëpunon me strukturat brenda institucionit, për alokimin dhe propozimin për ndryshimet në strukturën e organizimit të ERE. Drejton procesin e planifikimit, në bashkëpunim me drejtuesit e strukturave, për lejet e zakonshme për personelin dhe plotëson me shkrim dokumentacionin për dhënien e lejes së miratuar nga titullari i institucionit. Monitoron respektimin e orareve të punës, disiplinës dhe etikës nga punonjësit. Udhëheq procesin për rishikimin e përshkrimeve të punës, monitorimin e detyrave dhe ngarkesës së punonjësve, dhe në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm bëjnë propozimet përkatëse në Bord. Harton politikat e burimeve njerezore për mbulimin e nevojave të institucionit për staf të ri apo specialistë mbështetës.

2. RREGULLAT DHE PROCEDURAT QE NDJEK ERE

Proceset administrative në ERE rregullohen nga Ligji Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Ligji Nr. 102/2015, “Per sektorin e gazit natyror”, Kodi i Procedurave Administrative” Ligji Nr.8480, datë 27.05.1999, Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”., ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe nga aktet nënligjore të tjera si dhe ato të miratuara nga ERE të cilat përcaktojnë procedurat për rastet që vijnë për shqyrtim në ERE.

2.1 Legjislacioni sekondar - Rregulloret dhe udhëzimet e ERE

ERE publikon rregullat dhe rregulloret lidhur me praktikën dhe procedurat në lidhje me standardet e shërbimeve të ofruara prej saj. Para se ERE të miratojë rregulla ose të bëjë ndryshime në rregullat ekzistuese, ndjek një proces konsultimi përfshirë zhvillim të seancave dëgjimore me palët e interesit. Kjo siguron transparencë, dhe ju mundëson palëve të shprehin komente e të jenë pjesë e diskutimeve, dhe nga ana tjetër i mundëson ERE të adresojë në legjislacionin sekondar çështjet e interesit të palëve për të vendosur një balancim të interesave të aktorëve të ndryshëm të cilëve ju drejtohen aktet e ERE. Kuadri Rregullator në sektorin e energjisë konsiston kryesisht në aktet të tilla si:

- Kontrata tip e shërbimit universal të furnizimit;
- Rregullore për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- Metodologji e llogaritjes të çmimit për furnizuesin e shërbimit universal,
- Metodologji e llogaritjes së tarifës së transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë,
- Kodi i transmetimit së energjisë elektrike
- Rregullore për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë ;
- Hartimi i licencave në aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, operimit të tregut dhe tregtimit të energjisë;

Më shumë informacion ose për të qenë pjesë e konsultimeve për aktet në proces gjendet në linkun:

<https://www.ere.gov.al/sq/publikime/konsultime>

ERE siguron udhëzime shtesë për shërbimet e rregulluara në lidhje me politikat dhe procedurat përmes broshurave informative dhe informacioneve periodike në faqen e saj të internetit dhe në rrjetet sociale facebook, instagram dhe linkedIn.

Po ashtu ERE përditëson dhe dokumentacionet që lidhen me aktet e Këshillit të Ministrave apo Ministrisë së linjës për çështjet nën kuadrin rregullator të sektorit të energjisë.

2.2 Si fillon një procedurë në ERE?

Një procedurë në ERE mund të iniciohet në disa mënyra, duke përfshirë këto:

- Kërkesë e paraqitur nga një ndërmarrje e rregulluar që kërkon vendimarrjen e ERE për një akt të ri apo për ndryshim të një akti ekzistues, për miratimin e planit të investimeve; për përcaktim tarife;
- Ankesën e paraqitur nga një klient kundër veprimeve apo mosveprimeve të një furnizuese;
- Kërkesë për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet pjesëmarrësve të tregut;
- Kërkesë për licencim në një nga aktivitetet e përcaktuara në ligj;

I detajuar informacion mbi proceset që ndiqen nga ERE gjendet në linkun:

<https://www.ere.gov.al/sq/legjislacioni/legjislacioni-sekondar>

([http://ere.gov.al/doc/rregullorja_e_funksionimit_te_ere_miratuar_me_vendimin_nr_96_date_17_06_\(1\).pdf](http://ere.gov.al/doc/rregullorja_e_funksionimit_te_ere_miratuar_me_vendimin_nr_96_date_17_06_(1).pdf))

2.3 Seancat dëgjimore

Pjesë e procedurave të ERE janë dhe seancat dëgjimore. ERE gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi në sektoret e energjisë elektrike dhe gazit natyror mund të organizojë seancat dëgjimore teknike dhe seanca zyrtare publike.

ERE zhvillon seanca zyrtare publike me qëllim marrjen e komenteve nga palët e interesuara lidhur me tarifat dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Këto dëgjime publike u japin palëve të interesuara mundësi për të shprehur mendimet e tyre në lidhje me aplikimet që janë paraqitur në ERE.

Po ashtu ERE zhvillon rast pas rasti seanca teknike me të licencuar që kanë aplikuar për rishikim tarife; çmimeve; marrjen, ndryshimin, transferimin, rinovimin apo heqjen e një licence; miratimit të akteve të tjera nga ERE, si dhe në rastet e mosmarrëveshjeve që kanë lindur për zbatimin e një akti apo vendimi të ERE-s, apo gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve në tregun e rregulluar si dhe për çështje të tjera nën përgjegjësinë e ERE-s.

2.3 Mbledhjet e Bordit

Me qëllim organizimin e punës në ERE dhe planifikimin e detyrave dhe përgjegjësi të ERE-s në ushtrimin e autoritetit ligjor, Bordi zhvillon mbledhje të paktën 1(një) herë në muaj. Përveç mbledhjeve lidhur me çështje që janë objekt i brendshëm i ERE-s, të gjitha mbledhjet e Bordit do të janë të hapura për publikun. ERE siguron njoftimin për publikun 48 orë para zhvillimit të një mbledhje të hapur të programuar të Bordit të ERE-s. Njoftimi përmban datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes si dhe rendin e ditës. Njoftimi për

zhvillimin e mbledhjes vendoset në një vend të posaçëm në hyrje të ERE-s, si dhe publikohet në faqen zyrtare të ERE-s në internet.

2.3.1 Çeshtjet tipike që trajtohen me Vendim Bordi

Bordi merr vendim për çdo aplikim që ka të bëjë me ushtrimin nga ERE të autoritetit për:

- a. dhënie, ndryshim, rinovim, transferim, heqje licence,
- b. çertifikim të Operatorëve të Transmetimit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit Natyror,
- c. përcaktim të tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike dhe te gazit natyror për aktivitetet e rregulluara,
- d. dhënie të çertifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë,
- e. Për kërkesat për përjashtim nga aksesi i palëve të treta të infrastrukturave të reja apo ekzistuese të gazit natyror,
- f. Miratimin e të gjitha akteve nënligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, Ligjit për Burimet e Rinovueshme apo në zbatim të Modelit të Tregut të Energjisë, Strategjisë Kombëtare të Energjisë.

Vendimi i Bordit për fillimin ose jo të procedurës si rregull merret jo më vonë se 12 ditë pune nga rregjistrimi i aplikimit për licencim në ERE. Bordi merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit nëse konstaton se aplikimi plotëson kryesisht kërkesat sipas rregulloreve përkatëse.

2.3 .2 Procedimi i aplikimit për marrje licence

ERE ka kompetenca të:

- të miratojë procedurat e licencimit për aktivitetin prodhimit, shpërndarjes, transmetimit, tregtimit, furnizimit të energjisë
- të japë licenca në aktivitetet e sipërcituara
- të ndryshojë, transferojë dhe heqë licencat në sektorin e energjisë elektrike.

Licencat që lëshon ERE jepen me një afat të caktuar me të drejtë rinovimi dhe modifikimi:

- | | |
|--|-------------------|
| • Për Prodhimin e energjisë elektrike | - Deri në 30 vjet |
| • Për Transmetimin e energjisë elektrike | - Deri në 30 vjet |
| • Për Shpërndarjen e energjisë elektrike | - Deri në 30 vjet |
| • Për Furnizimin e energjisë elektrike | - Deri në 5 vjet |
| • Për Tregtimin e energjisë elektrike | - Deri në 5 vjet |
| • Për Transmetimin e gazit natyror | - Deri në 30 vjet |

- Për Shpërndarjen e gazit natyror - Deri në 30 vjet
- Për Furnizimin e gazit natyror - Deri në 10 vjet
- Për Tregtimin e gazit natyror - Deri në 10 vjet
- Për Operimin në hapësirat e depozitimit të gazit natyror - Deri në 30 vjet
- Për Operimit në impiantet e GNL-së - Deri në 10 vjet
- Për funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror - Deri në 10 vjet

Një person që kërkon të licencohet në një apo më shumë nga aktivitetet e parashikuara në Ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” apo në aktivitetet e parashikuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, duhet të paraqesë në ERE një aplikim sipas formatit të kërkuar nga ERE në rregulloren për procedurat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Pasi Bordi të ketë marrë vendim për fillimin e procedurës së shqyrtimit të një aplikimi për licencë, drejtorja e ngarkuar për shqyrtimin e aplikimit, përgatit njoftimin e aplikimit për licencë. Brenda 2 ditëve nga data e marrjes së vendimit për fillimin e procedurave ERE publikon në median e shkruar njoftimin për aplikimin për licencim të subjektit aplikues dhe siguron një periudhë të caktuar rast pas rasti për çdo aktivitet, për të pritur të gjitha kundërshtimet e palëve të treta lidhur me këtë aplikim. Bordi i ERE, merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, brenda afateve që përcaktojnë aktet e sipërcituara, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit në shtyp.

2.3.3 Procedura e aplikimeve për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve.

I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin të kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse. Mbas shqyrtimit paraprak dhe në kushtet kur aplikimi i plotëson kryesisht kërkesat, ERE merr vendimin për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit. Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, drejtoritë teknike/grupi i punës i ngarkuar, përgatisin për të licencuarin/it, njoftimin për Vendimin e Bordit. Në çdo kohë gjatë shqyrtimit të një aplikimi për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, ERE ruan të drejtën për të kërkuar çdo informacion që e konsideron të nevojshëm për vendimmarrjen e saj në lidhje me aplikimin e paraqitur.

Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit i licencuari duhet të njoftojë:

a. Brenda 10 ditëve kalendarike publikun, nëpërmjet botimit jo më pak se në dy/tre gazeta me qarkullim në nivel vendi, apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbimin, në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e tarifave dhe çmimeve, si dhe përqindjen e ndryshimit të tyre për çdo klasë/grup konsumatoresh duke shprehur qartë emërtimin e tyre. Në çdo rast brenda tre diteve kalendarike nga botimi i njoftimit i Licencuari do të njoftojë ERE-n për kryerjen e botimit në gazetë.

b. Në rastet kur aplikuesi nuk bën publikimin sipas paragrafit të mësipërm, ERE-ja mund të vendos për penalizimin e aplikuesit dhe bën publikimin e aplikimit sipas kërkesave të paragrafit të mësipërm. Kostot e botimit të këtij njoftimi i transferohen subjektit që ka detyrimin për publikim.

Gjatë shqyrtimit të aplikimit ERE organizon seanca dëgjimore teknike me aplikuesin, si dhe në çdo rast zhvillon seanca dëgjimore publike sipas rregullave për zhvillimin e seancave dëgjimore.

Si rregull ERE do të shpallë vendimet mbi përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve brenda datës 15 dhjetor të vitit që është paraqitur aplikimi.

2.3.4 Aksesi i palëve në informacion

ERE ka miratuar një strategji komunikimi për Entin Rregulltor të Energjisë, e cila ka qëllim të adresojë synimet e ERE në ndërtimin dhe ruajtjen e një marrëdhënie me publikun si dhe plaët e interesit në vendimmarrjet e ERE apo çështjet në kompetencë të saj. Në strategjinë e komunikimit të ERE janë identifikuar palët e interesit si dhe palët ndaj të cilëve synohet që të arrijë rezultatin e kërkuar përcjellja me iniciative të ERE apo dhënia e informacionit sipas moduleve të parashikuara në të. Strategjia e Informimit nga ERE bazohet në modelet :

Politikë e Hapur

Politikë Përfshirëse

Politikë e Hapur: Kjo do të thotë që në proceset që ERE zhvillon, të sigurojë qytetarët me informacion dhe të bëjë procesin e politikës rregullatore të qasshme e të kuptueshme;

Forma tjetër është përmes politikave gjithëpërfshirëse, që do të thotë përfshirja më e gjerë e zërave të qytetarëve në procesin e hartimit të politikave sa më shumë që të jetë e mundur. Angazhimi me palët e interesuara në fillim të procesit lejon kultivimin e marrëdhënieve proaktive që mund të jenë thelbësore për qëndrueshmërinë e vendimeve rregullatore.

Informacion i Përgjithshëm përmes kanaleve digjitale

ERE përdor gjërësisht kanalet dixhitale për transmetimin e informacioneve brenda fushës së rregullimit. Këto informacione përfshijnë kryesisht:

- Të drejtat e konsumatorëve tarifave
- Proceset e menaxhimit të ankesave
- Informacion mbi Cilësinë e Shërbimit
- Aktet që rregullojnë aspektet që lidhen me fushat e përgjegjësisë së ERE të tilla si për licencimet, ankesat, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, aksesin në rrjet.

ERE përditëson rregullisht në faqen e saj të internetit informacion mbi:

- Përmbledhje të vendime të marra në mbledhjen e Bordit të ERE-s;
- Broshurat e përgatitura nga drejtori të ndryshme të ERE-s;
- Rregjistrin e ankesave dhe kërkesave etj
- Rregjistrin e të licencuarve.

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ERE ka caktuar një prej nëpunësve të saj si Koordinator për të drejtën e informimit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit. Informacion për sa më sipër gjendet në linkun:

<https://www.ere.gov.al/sq/transparenca/koordinatori-per-te-drejte-e-informimit>

3. Përcaktimi i tarifave

3.1 Përse tarifave të shërbimit dhe çmimi i furnizuesit universal rregullohen nga ERE

Shërbimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike realizohen përmes investimesh shumë të mëdha kapitale në infrastrukturën e rrjetit duke përfshirë investimet në linjat e transmetimit dhe shpërndarjes për qëllime të zgjerimit të rrjetit por edhe për të mirëmbajtur këto rrjete. Për të shmangur kostot e larta të dyfishimit të infrastrukturës, operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes të cilët ushtrojnë një aktivitet monopol në sistemet respektive, në raport të shërbimeve që ofrojnë ato janë të detyruara t'i shërbejnë publikut për një furnizim të sigurtë, të qëndrueshëm, pa diskriminim. Kostot e shërbimit të këtyre operatorëve në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike i nënshtrohen vlerësimit nga ERE. Ky vlerësim nga ERE bazohet në metodologjinë e miratuar nga ERE. Tarifa e shpërndarjes duhet të :

a) Shlyejë kostot e pronësisë, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjen e linjave, kablove, nënstacioneve të transformatorëve dhe ndërtesave që lidhen me to.

b) Tarifa për operatorin e sistemit të shpërndarjes duhet të reflektojë koston aktuale të shërbimit për çdo grup konsumatorësh sipas niveleve të tensionit.

c) Tarifa e shpërndarjes duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që të mos lejojë ndërsbvencionimin ndërmjet grupeve të klientëve.

d) Klienteve fundorë do t'u shpërndahen kostot e humbjeve të energjisë elektrike në varësi të nivelit të tensionit ku ata furnizohen. Energjia elektrike e përdorur nga klientët që nuk maten tek pika e tyre tregtare e lëvrimit të shërbimit do të rregullohet në mënyrë që të mbulohen humbjet e energjisë nga pika tregtare e lëvrimit tek pika e matjes.

e) Kosto e blerjes së energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes (sipas objektivit të përcaktuar nga ERE sipas kësaj metodologjie) përfshihet në tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit.

Si pjesë e procesit të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të rregulluara, ERE përcakton shumën totale të të ardhurave të krijuara nga operacionet që kërkohen që kompania për të përmbushur objektivat dhe nevojat e saj dhe shumën e kërkuar për të plotësuar nevojat për një shërbim cilësor dhe me kosto të justifikuar për klientët.

3.2 Faktoret që ndikojnë në përcaktimin e tarifave

Në përcaktimin e tarifave ndikojnë disa faktorë të tillë si:

Kapaciteti total i lëvruar në kW të kërkuar për sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm me energji në çdo grup klientësh.

Energjia totale në kWh që do të tregohet në faturat e klientëve fundorë në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e tyre totale të faturimit.

Niveli i humbjeve në sistemin e shpërndarjes që i ngarkohen klientëve fundorë në çdo nivel tensioni (kosto e humbjeve do të përfshihet në pagesat për energji (koston variabël) për secilin grup të klientëve) (niveli i lejuar i humbjeve).

4. Monitorimi

Monitorimi i tregut është një element kryesor i përgjegjësive rregullatore i cili lidhet me ushtrimin e akitivitetit të ERE për kontrollin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe marrjen e masave të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut. ERE monitoron:

a) zbatimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike;

b) zbatimin e detyrimit të transparencës prej të licencuarve;

c) efektivitetin e konkurrencës së tregut në nivel shitjeje me shumicë dhe pakicë, shkëmbimet, rregullat e ndryshimit të furnizuesit, rregullat e shkëputjes nga rrjeti, pagesat

- e shërbimeve të mirëmbajtjes, ankesat e klientëve dhe çdo shtrembërim apo kufizim të konkurrencës, duke informuar Autoritetin e Konkurrencës për rastet e konstatuara;
- ç) nënshkrimin e kontratave kushtëzuese, përfshirë këtu edhe kontrata me kushte të veçanta përjashtuese, të cilat mund të pengojnë klientët jofamiljarë të mëdhenj të kontraktojnë njëkohësisht më tepër se një furnizues apo të kushtëzojnë zgjedhjen e kësaj mundësie prej tyre. Në këto raste, ERE duhet të informojë Autoritetin e Konkurrencës;
- d) afatet brenda të cilave operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes përfundojnë lidhjen në rrjet të klientëve të rinj apo kryejnë riparimet në rrjete;
- dh) zbatimin e rregullave lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
- e) investimet në kapacitetet e reja prodhuese, lidhur me sigurinë e furnizimit;
- ë) zbatimin e masave të sigurisë së furnizimit, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji;
- f) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit;
- g) bashkëpunimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje apo operatorët e rrjeteve evropiane të transmetimit të energjisë elektrike, përfshirë monitorimin e zbatimit të mekanizmit të kompensimit ndërtransmetues të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, vendosur në kuadër të këtij bashkëpunimi;
- gj) zbatimin e rregullave për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksioneve, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore ose autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera fqinje, me të cilat është vendosur interkoneksioni;
- h) menaxhimin e kapacitetit të kufizuar në rrjetin e transmetimit, përfshirë interkoneksionet dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar;
- i) publikimin e informacionit të duhur prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit, lidhur me interkonektorët, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapaciteteve ndaj palëve të interesuara, duke ruajtur konfidencialitetin për informacionin e marrë;
- j) ndarjen efektive të llogarive, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të shmangur ndërsuvencionimet midis aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;
- k) kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve të rinj.

Procesi i një Monitorimi

Kryesisht në rastet e kontrollit apo monitorimit të aktivitetit të subjekteve të licencuara, Kryetari ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm për mbarëvajtjen e proceseve të punës, nga grupi i punës i propozuar nga Drejtoritë përkatëse me jo më pak se tre përfaqësues të ERE-

s. Një monitorim me objekt specifik ndaj një të licencuari do të nisë vetëm pas miratimit nga Kryetari të programit të punës, urdhrin dhe autorizimit të përgatitur nga Drejtoria propozuese. Në çdo rast anëtarët e grupit të monitorimit paraqiten tek i monitoruari të pajisur me kartë identiteti si dhe zbatojnë rregullat e kryerjes së monitorimit, siç përcaktuar në Urdhrin e Kryetarit të ERE. Në përfundim ose gjatë kontrollit/monitorimit, grupi i punës i paraqet Bordit një informacion të detajuar dhe konkluzionë apo rekomandime për problematikat e trajtuara. Bordi i ERE mbështetur në konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të punës që kanë ushtruar kontrollin/monitorimin, do të vendosë sipas rastit për rekomandimet apo masat që duhen marrë për inkurajimin, parandalimin ose marrjen e masave administrative ndaj subjektit ku është ushtruar kontroll/monitorim në përputhje me autoritetin që i jep ligji. Para dorëzimit në Bord, informacioni i monitorimit apo kontrollit të ushtruar i bëhet me dije subjektit të licencuar ku është ushtruar kontroll për t'i dhënë mundësi të shprehë qëndrimin apo kundërshtimet e tij mbi konstatimet e grupit të punës sipas afateve të përcaktuara në Urdhrin e Kryetarit për ngritjen e grupit të punës. Bordi i ERE mbështetur në konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të punës që kanë ushtruar kontrollin/monitorimin, do të vendosë sipas rastit për rekomandimet apo masat që duhen marrë për inkurajimin, parandalimin ose marrjen e masave administrative ndaj subjektit ku është ushtruar kontroll/monitorim në përputhje me autoritetin që i jep ligji. Në përputhje me kompleksitetin e një raporti monitorimi rasti pas rasti, çdo anëtar i Bordit ka të drejtë të kërkojë opinionin e Sekretarit të Përgjithshëm, Këshilltarit dhe të Drejtorit të DJZM dhe Drejtorit të drejtorisë që ka iniciuar monitorimin, kur e konsideron të nevojshme. Për rastet kur, me vendim të Bordit është vendosur një afat për të licencuarin, për kryerjen e veprimeve korigjuese, personat e ngarkuar për kontrollin/monitorimin do të verifikojnë mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të vendimit nga i licencuari dhe në çdo rast do të përgatisin një relacion argumentues për Bordin e ERE-s, për sa konstatuar, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni mbi qëndrimin e të licencuarit. Në çdo rast, për praktikën për shqyrtim në Bord, të përgatitura nga Grupet e Punës të ngritur me Urdhër të kryetarit në kuadër të ushtrimit të kompetencave rregullatore, informacionet, relacionet dhe propozimet përkatëse të Grupit të Punës do të bashkëlidhet edhe opinioni i Këshilltarit të Bordit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit respektiv sipas objektit të rregullimit të çështjes për shqyrtim, Nëse kjo kërkohet nga një anëtar i Bordit.

5. Hartimi dhe miratimi i akteve rregullatore - Konsultimi

ERE në frymën e qëllimit dhe objektivave të ligjit harton gjithë korpusin e plotë rregullator të akteve nënligjore të cituara më sipër. është me rëndësi të vëmë në dukje se të gjitha këto akte përfaqësojnë legjislacionin sekondar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili trajton në mënyrë të detajuar, të gjitha procedurat dhe metodologjitë e operimit në këtë treg. Këto akte mbasi miratohen me vendime të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, publikohen në gazetën Zyrtare dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit dhe pjesmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike. Hartimi dhe përpunimi i këtyre akteve është fryt i një pune të përbashkët me pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike si dhe i mbështetjes së organizmave ndërkombëtarë që kanë dhënë asistencën e tyre të çmuar në këtë proces. Të gjitha aktet që janë miratuar nga ERE, më parë i nënshtrohen konsultimit publik si pjesë e procesit të zbatimit të ligjit. Për këtë qëllim ERE ka miratuar rregulloren që përcakton rregullat mbi organizimin e procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projekt-akteve që miratohen për kompetencë nga ERE sipas parashikimeve të ligjit nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar, ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Në kuptim të kësaj rregullore, ERE do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

- a) publikimin në faqen e internetit të ERE të projektaktit dhe relacioni shpjegues mbi projektaktin.
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planit vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes së akteve normative;
- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri në miratimin e aktit përfundimtar.

ERE, pas marrjes së vendimit të fillimit të procedurës për miratimin e një akti, si dhe publikimit të projektaktit në faqen e internetit të ERE, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe seanca dëgjimore me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt;

b) të përcjellin në ERE brenda afateve të parashikuara, komente dhe sugjerime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Njoftimi në faqen zyrtare të ERE për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet:

a. Njoftimit për organizimin e seancës publike në faqen zyrtare të ERE;

b. nëpërmjet regjistrimit elektronik;

c. nëpërmjet botimit të projektaktit në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar;

d. Me njoftimin nëpërmjet postës tek palët e interesit, të projektaktit dhe ftesës për komente apo opinione. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë ERE komentet dhe rekomandimet e tyre brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, ERE mund të zgjasë deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit, këtë afat. Konsultimi në seanca publike është i hapur.

Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të ERE, dhe i përcillen për trajtim strukturës përgjegjëse të ERE në varësi të fushës së kompetencës përcaktuar në Strukturën organizative të ERE.

Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga Struktura/t përgjegjëse e ERE për hartimin e projektaktit, e/të cilat vendosin për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara. Projektaktet shoqërohen me një relacion të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë struktura përgjegjëse paraqet në relacion një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre.

6. Mbrojtja e konsumatorit

Ligjet respektive në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe në Sektorin e Gazit natyror përcaktojnë edhe fushën e përgjegjësisë së ERE si një rregullator i pavarur që të sigurojë mbrojtjen e konsumatorit. Për qëllime të mbrojtjes së konsumatorit për një furnizim të vazhdueshëm, me energji nga kompanitë e licencuara, ligji ka përcaktuar që rregullat dhe kushtet e furnizimit dhe ofrimit të shërbimeve nga të licencuarit, duhet të miratohen nga

ERE mbi bazën e parimeve të tilla si transparenca, ofrimi i shërbimit me koston më të ulët nga të licencuarit. Mbrojtja e konsumatorit nga ERE përfshin:

Monitorimi

Përmes kontrollit periodik të shërbimeve të ofruara nga i licencuari ERE vlerëson periodikisht treguesit e cilësisë së shërbimit dhe furnizimit nga i licencuari.

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, neni 19, gërma “h” dhe “j” e ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; ERE ka miratuar Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Qëllimi i kësaj rregullore është specifikimi i treguesve të cilësisë së furnizimit dhe kërkesave të operimit, si dhe performanca në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe krijimin e kushteve të një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë (brenda limiteve të lejuara të përcaktuara në këtë rregullore) me energji elektrike, të klientëve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Treguesit e Matjes së Cilësisë së Shërbimit, të cilët duhet të llogariten nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të raportohen në ERE janë si më poshtë:

- a. Energjia e pafurnizuar (ENS)
- b. Koha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në Sistemin e Shpërndarjes
- c. Përqindja e klientëve me lexim aktual të matësve
- d. Zgjidhja e ankesave lidhur me cilësinë e tensionit
- e. Koha e nevojshme për tu përgjigjur ndaj ankesave të klientëve lidhur me matjen
- f. Koha e nevojshme për tu përgjigjur ndaj kërkesave për Lidhje të Reja
- g. Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)
- h. Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve (SAIFI)
- i. Koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit pas një defekti në sistemin e shpërndarjes
- j. Koha e nevojshme për rilidhjen e klientëve të ndërprerë për arsye të mospagesës
- k. Koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit
- l. Cilësia e Tensionit (VQ)

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka përgjegjësinë të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme për llogaritjen e treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregullore. Të dhënat duhet të llogariten mbi baza tre mujore dhe në mënyrë progresive përgjatë vitit kalendarik dhe treguesit e matjes cilësisë së shërbimit duhet ti raportohen ERE-s jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tre mujorit. Për

shembull, brenda datës 30 janar të çdo viti duhet të raportohen të dhënat vjetore në progresiv për vitin paraardhës (nga muaji Janar në Dhjetor).

Të dhënat e llogaritura të treguesve të matjes së cilësisë së shërbimit, për tre mujorin e dytë deri në atë të katërt, krahas të të dhënave të secilit tre mujor, duhet të përmbajnë dhe ato progresive, ku përfshihen të dhënat e vitit aktual.

—Kriteret Standarde të Performancës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes gjenden të publikuara si pjesë integrale e Rregullores së sipërcituar.

Të dhënat që lidhen me cilësinë e shërbimit siç cituar më sipër gjenden të publikuara në Raportet vjetore të ERE në linkun:

<https://ere.gov.al/sq/publikime/raporte-vjetore>

Trajtimi i ankesave dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për qëllime të trajtimit të ankesave është ngritur dhe funksionon një strukturë e dedikuar brenda ERE për të ofruar shërbime për publikun e gjerë. Qëllimi është të sigurojë që interesi i konsumatorëve dhe shërbimeve të mbrohen në nivel kombëtar.

Ankesat trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në RREGULLOREN PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË PARAQITURA NGA KLIENTËT DHE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE MIDIS TË LICENCUARVE, NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR, miratuar nga ERE.

Kjo rregullore, përcakton hapat procedural që duhet të ndiqen për të siguruar të drejtën e konsumatorit që paraqet ankesën ndaj furnizuesit të tij apo ndaj operatorit të rrjetit.

Pranimi dhe regjistrimi i ankesave në ERE

Çdo klient ka të drejtë të drejtohet me ankesë pranë ERE-s në këto raste:

1.1. Në rast se i licencuari, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të ndërmarra nga ana e tij, ka shkelur dhe cënuar kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit të shërbimit universal, si dhe akteve të tjera që lidhen me furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror, të miratuara nga ERE.

1.2. Kur klienti ka përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigjja e dhënë nga i licencuari;

1.3. Në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari brenda afatit të parashikuar në rregulloren e të licencuarit “Për trajtimin e ankesave” dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të miratuara nga ERE.

Rregullorja “Për trajtimin e ankesave” e të licencuarit publikohet në një vend të dukshëm pranë çdo përfaqësie të tyre.

1.4. Çdo rrethanë tjetër që mund të përbëjë shkak për lindjen e një ankesë të klientit ndaj të licencuarve.

Çdo ankesë e paraqitur në ERE, regjistrohet në format elektronik apo të shkruar.

Regjistrimi përfshin:

- a) Një kod unik identifikues;
- b) Datën e paraqitjes së ankesës, identitetin e parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të tij;
- c) Numrin i kontratës së furnizimit me energji elektrike apo gaz natyror;
- d) Subjektin ndaj të cilit ankohet ankuesi;
- e) Objektin e ankesës dhe një përmbledhje të saj;
- f) Nëse klienti është ankuar më parë në ERE apo tek i licencuari, për të njëjtin objekt ankimi, për të cilin bëhet ankesa e re;
- g) çdo informacion apo dokument tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesës.

ERE në të gjitha rastet do të pranojë një ankesë vetëm në rastet kur ankuesi paraqet informacionin minimal të përcaktuar më sipër. Të gjitha komunikimet ndërmjet ERE-s dhe ankuesit lidhur me ankesën, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues. Pranimi dhe trajtimi i ankesave të klientëve dhe të të licencuarve nga ERE, do të jetë një shërbim i ofruar pa pagesë.

ERE ka miratuar Formularin e Ankesës i cili mund të aksesohet në linkun <https://www.ere.gov.al/sq/sherbime-konsumatori/formulari-i-ankesave>

Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ERE

Trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ERE do të konsistojë në hetimin dhe verifikimin e të gjitha rrethanat dhe të dhënat lidhur me ankesën e regjistruar. ERE, sipas rastit, do të dërgojë për verifikim ankesën pranë subjektit të ankimit brenda 15 ditëve kalendarike. I licencuari është i detyruar të kthejë përgjigje për trajtimin e ankesës brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së shkresës. Në rast se kërkohet nga i licencuari më tepër kohë për trajtimin e ankesës, ky afat mund të zgjatet me 20 ditë të tjera kalendarike. ERE, mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi ose nga i licencuari ndaj të cilit paraqitet ankesa, brenda 10 ditëve kalendarike pas pranimin të ankesës. ERE, pasi të ketë reregjistruar ankesën dhe pasi të ketë filluar trajtimin e saj, mund të vendosë që nuk ka juridiksion mbi çështjen. Në çdo fazë të shqyrtimit të ankesës, nëse e çmon të arsyeshme ERE, mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Palëve u jepet një afat jo më pak se 5 ditë kalendarike kohë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancë dëgjimore përfshin çështjet që do të trajtohen në seancë dëgjimore. Pas përfundimit të

trajtimit të ankesës, ERE duhet të informojë ankuesin dhe të licencuarin ndaj të cilit është paraqitur ankesa, për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin. Në rastet kur ankesa rezulton e drejtë, ERE i komunikon të licencuarit, veprimet korigjuese apo kompensuese, të cilat duhet të ndërmarrë ndaj klientit, në përputhje me “Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” dhe “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, si dhe “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”. Veprimet e kërkuara nga ERE ndaj të licencuarit, për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të klientëve, janë të detyrueshme për të licencuarit, subjekt i ankimimit. Afati maksimal i trajtimit dhe i zgjidhjes së ankesave të furnizimit me energji elektrike është 30 ditë kalendarike nga regjistrimi i ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera kalendarike, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

Komunikimi

Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesës, duhet t'i komunikohet ankuesit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit ose veprimit të ndërmarrë.

Publikimi i të dhënave lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave

ERE do të publikojë në faqen zyrtare të internetit, numrin e ankesave dhe mosmarrëveshjeve të paraqitura, objektin e tyre, masat dhe veprimet e ndërmarra për eliminimin e tyre.

7. Angazhimi me palet e treta dhe insitucionet ndërkombëtare

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e ERE-s zë zhvillimi i marrëdhënieve ndërinstucionale brenda vendit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Në zhvillimin e marrëdhënieve ndërinstucionale mund të përmendim marrëdhënien me Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë përgjegjëse për energjinë, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, si dhe institucione të tjera në vend. Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin zhvillohen në përputhje me përcaktimet e ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror. Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, ERE raporton çdo vit në Kuvend një raport mbi “Gjendjen e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s“. Raportet vjetore paraqiten në mënyrë të detajuar me të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin respektiv , si dhe

krahasimet e disa prej treguesve kryesor të një viti me vitet parardhës. Ndër të tjera përmban dhe informacion mbi:

- sigurinë operative të rrjetit;
- balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare;
- nivelin e pritshëm të kërkesës dhe perspektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare nga data e raportit;
- kapacitetin shtesë prodhues të propozuar, të planifikuar apo në fazë ndërtimi;
- parashikimin e investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit;
- cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;
- masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike;
- masat e përshtatshme, në rast nevojë, të rritjes së sigurisë së furnizimit.
- parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit;
- modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës;
- objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe europian;
- informacionin e hollësishëm të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, për investimet e parashikuara për linjat e interkonjeksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndikojnë në linjat e interkonjeksioneve ndërkufitare.

Gjithashtu në kuadër të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin Nr. 134/2019 të Kuvendit të Shqipërisë, “Mbi miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, ERE ka detyrimin të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me gjetjet gjatë ushtrimit të funksionit të vetë monitorues. Po ashtu ERE në çdo rast informon mbi veprimtarine institucionale në zbatim të kërkesave të Kuvendit sipas rastit.

7.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë përgjegjëse për Energjinë

ERE bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për energjinë jo vetëm si një kërkesë e ligjit për sektorin e energjisë elektrike por edhe si një nevojë e diskutimit dhe gjetjes së zgjidhjeve më të mira në kuadër të sigurimit të vazhdueshëm e me koston më të lirë të

energjisë elektrike për konsumatorët, garantimin e të drejtave të tyre por edhe të sigurimit të operimeve të operatorëve në treg. Format e bashkëpunimit përfshijnë diskutimin reciprocisht të propozimeve të dala prej saj apo përmes dhënies së opinionit për ndryshime e propozuara, përfshirë nëpërmjet pjesëmarrjes në Grupet ndërinstitucionale të Punës për rishikimin e legjislacionit primar e sekondar të sektorit. Gjithashtu, bashkëpunimi përfshin pjesëmarrjen në seancat dëgjimore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me të licencuarit dhe me të gjitha palët pjesëmarrëse në sektorin e energjisë në Shqipëri. Po ashtu, ERE bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për energjinë në kuadër edhe të seancave mbi çështjet që lidhen me zbatimin e ligjeve për sektorin energjisë elektrike, atë burimeve të rinovueshme, të gazit natyror si dhe në kuadër të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me fushën e përgjegjësisë së ERE.

7.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës

Pjesë e rëndësishme e konsultimeve të ERE në proceset e miratimit të akteve rregullatore, përcaktimit të tarifave etj, është bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës bazuar në marrëdhënien e institucionalizuar mes këtyre dy institucioneve meë synim shmangien e shkeljes së konkurrencës nga operatorët, duke krijuar rregulla që nuk vijnë në kundërshtim me aktet ligjore për konkurrencën e që nuk çënojnë interesat e konsumatorëve. ERE kërkon rregullisht mendimin e Autoritetit për aktet nënligjore që lidhen me zhvillimin e tregut të energjisë përpara se të miratohen nga ERE, e po ashtu edhe në procesin e shqyrtimit të aplikimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike. Nga ana tjetër edhe ERE merr pjesë në seancat që zhvillon Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të proceseve hetimore dhe investigimeve për sektorin e energjisë elektrike duke shprehur opinionin e tij dhe duke ofruar ekspertizën për çështjet brenda fushës së përgjegjësisë së ERE.

7.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit

ERE rregullisht bashkëpunon me Avokatin e Popullit, i cili sikurse edhe ERE, ka në fushën e veprimtarisë së tij mbrojtja e konsumatorëve. Për këtë qëllim ka ofruar rregullisht informacionet e nevojshme, ku me sensitivet janë ato mbi vendosjen e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike. Institucioni i Avokatit të Popullit është gjithashtu pjesë e proceseve konsultative dhe seancave dëgjimore që zhvillohen kryesisht për tarifatat e energjise elektrike apo dhe në kuadër të mosmarrëveshjeve që lindin mes konsumatorëve dhe furnizuesve.

7.5 . Marrëdhëniet ndërkombëtare

Që prej fillesave të punës së ERE, pjesë e rëndësishme e ushtrimit të veprimtarisë prej saj është përfshirja dhe shkëmbimi i eksperiencave në nivel ndërkombëtar. Angazhimin në

nivel me organizatat ndërkombëtare, por edhe bashkëpunimi bilateral, është një dimension i rëndësishëm me qëllim forcimin kapaciteteve institucionale, kualifikimeve dhe ekspertizës së punonjësve të ERE dhe përshtatjen e legjislacionin të brendshme me praktikën më të mira rajonale me ato të BE. Disa prej organizatave ndërkombëtare e të cilave ERE është anëtare, janë:

Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) ku ERE merr pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e grupeve të përhershme të ERRA-s. ERE gjithashtu ndjek trajnimet e organizuara nga ERRA.

Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut për Energjinë - Medreg, ka pjesëmarrje aktive në drejtimin e Presidencës së Medreg dhe po ashtu në drejtimin e grupeve të punës.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë

ERE raporton rregullisht në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi zhvillimet në tregun e energjisë, nivelin e hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore, treguesve të operatorëve publik, ndarjen e operatorëve, etj. ERE po ashtu merr pjesë rregullisht në aktivitetet që organizon Sekretariati i Vjenës, përfshirë takimet e grupeve të punës sikurse dhe aktivitetet trajnuese të tilla si ato mbi çështjet e konsumatorëve, tregut rajonal të energjisë etj.

ERE bashkëpunon me NARUC (Shoqata e Enteve Rregullatore të SH.B.A-së) dhe USAID, me mbështetjen e të cilëve janë mundësuar programet e partnershipit dhe internshipit. Me mjaft rëndësi është edhe mbështetja në kuadër të hartimit të akteve nënligjore për rregullimin e sektorit të energjisë.

Punoi Grupi i punës:

Erjola Sadushi – Kryetare

dhe Anëtarë:

Elton Rradheshi

Julia Guga

Orjana Kallaku

Gerti Bitri

Romir Pajenga

Afërdita Bushi

Bruna Tavani